

# FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

Albania Distribution Chemicals

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

M11815028I

NUIS/NIPT

Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6.

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0694000260

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@adchem.al

E-mail

Administrator Mamica Jançe

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2024/03/20

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0694000260

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-98619-03-18-2024

---

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

---

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

---

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat SH.A

---

Vlera e përllogaritur e prokurimit

*Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

5843667

---

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.*

Blerje Hipoklorit Kalciumi dhe Natriumi

---

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2024/03/29

---

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

*(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)*

---

Data e nënshkrimit të kontratës

*(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmëri të kontratës)*

---

Tipi i kontratës

Mallra

---

Data e zhvillimit të procedurës

2024/03/29

---

Numri i njoftimit

24312200-624312220-2

---

Kodi CPV

24312200-624312220-2

---

Ankese mbi argument në KPP

---

### **Seksioni III: Përshkrimi i ankesës**

## 1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji nr.162/2020, date 23.12.2020, "Per Prokurimin Publik"

Vendim nr.914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar me vendim nr.402, date 13.05.2015, me vendim nr.823, date 23.11.2016, me vendim nr.797, date 29.12.2017 dhe me vendim nr.80, date 14.02.2018 dhe me vendim nr.823, date 21.10.2020

Neni 2

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

---

## 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit
- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

*(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)*

- Tjetër

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

### **3. Rrethanat dhe faktet** □

*Përshkruani rrethanat e faktit.* □

Brenda afatit ligjor të parashikuar në Nenin 110, Nenin 111, të LPP, duam të paraqesim këtë ankesë përpara Autoritetit Kontaktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me skualifikimin e bërë nga ana e Autoritetit Kontraktor për Operatorin të Ekonomik.

1. Operatori ekonomik ankues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Bazuar në dispozitën ligjore të mësipërme, brenda afateve të përcaktuara nga neni i mësipërm, ne ju paraqesim ankesën e mëposhtme.

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Prokurimit,

Në datën 19.03.2024 Autoriteti Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat ka hedhur në sistemin e APP procedurën e prokurimit me objekt Blerje Hipoklorit Kalciumi dhe Natriumi.

Në datën 19.03.2024, i kemi dërguar këtij AK një kërkesë për sqarim ( gjëni bashkëgjatur ) në lidhje me një kriter të vendosur, por nuk kemi marrë përgjigje sipas Ligjit të Prokurimit Publik. Nëse si Operator Ekonomik, i interesuar duam të paraqesim argumentat tona në lidhje me kriteret abuzive që janë vendosur nga AK, duke qenë se nuk kemi marrë përgjigje nga AK për këto kritere. Neni 2

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

Se pari:

Shtojca 6

Çdo parti klori e ardhur në Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat Sh.a. do të shoqërohet me fletë analizën të cilat kryen nga laboratorit të Drejtorisë së Shëndetit Publik (I.SH.P.),

1. Grafiku i furnizimit, dhe oraret e dorëzimit të ngarkesave

Dërgimet e ngarkesave do të bëhen në bazë të një programi, 2000 l cdo dy muaj 2 e ndare 1500 litra do të depozitohet në Njesin Dimal dhe 500 litra në Njesin Skrapar për lenden Hipoklorit Natriumi 12-15% , që Drejtori i Shoqëris Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat do t'ja parashtrijë firmës kontraktuese me shkresë ose me email të paktën 5 ditë më parë duke përjashtuar rastet e veçanta e të pa parashikueshme kur periudha e mësipërme mund të ulet deri në 3 ditë dhe lajmërimi mund të bëhet edhe me telefon. Kërkesa për kimikate do të bëhet në sasi të dhe datat që do të jetë e nevojshme, kjo do të thotë se ka mundësi që sasi të mujore dhe datat e furnizimit me kimikatet e kërkuara të jetë pak të ndryshme ose të ndryshme krahasuar me grafikun e bashkëlidhur i cili është paraprak dhe orientues.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar fletë analizen nga I.SH.P ( Insituti i Shendetit Publik ) për çdo parti mall që do të furnizohet. Nga ana jone ky kriter është lehtësisht i realizueshem por koha që i duhet ISHP për të realizuar këto analize është 20 – 30 ditë dhe ky afat bie ndesh me kërkesën që ben Autoriteti për dorëzimin e mallit që është 3 ose 5 ditë. Në vijim të këtij sqarimi ju bejme me dije se Instituti i Shendetit Publik nga momenti që ben kërkesën për kryerjen e analizës deri në marrjen e kesaj analize zgjat të paktën 20 ditë. Për ta vertetuar sa me siper po ju dergojme disa nga Analizat tona të kryera tek ISHP, në të cilat shihet qarte data e kërkesës dhe data e protokollimit të Analizës ( duhet të keni parasysh edhe kohën që merr dërgimi me postë e analizës nga ISHP tek subjekti jone ). Bashkangjitur do gjeni disa analiza.

Për këto arsye është e pamundur të dorëzojme sebashku me Analizën e ISHP për 3 – 5 ditë nga momenti i kërkesës tuaj.

Kerkojme që të bëhet një modifikim tek ky kriter duke marrë parasysh sa me siper.

Se dyti:

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia /Vjetore
1	Hipoklorit Kalciumi	60-70%	Kg 26 200
2	Hipoklorit Natriumi	12-15%	litra 11 200

2.3.2 Me qëllim vërtetimin se produkti objekt prokurimi “Hipoklorit Natriumi”, është prodhuar nga prodhues të licencuar, dhe se është në përputhje me specifikimet teknike e standartet e kërkuara, Operatori Ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:  
- Lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shendetësisë për llojin e kimikatit, në rast se ofertuesi është vetë importues, dhe në rast se nuk është vetë importues, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit me një importues të këtij malli i cili disponon lejen e importit.

Autoriteti tek ky kriter ka kërkuar Lejen e importit të Hipoklorit Natriumi me pretekstin se ”Me qëllim vërtetimin se produkti objekt prokurimi “Hipoklorit Natriumi”, është prodhuar nga prodhues të licencuar, dhe se është në përputhje me specifikimet teknike e standartet e kërkuara, Operatori Ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë”  
Nuk kemi asnjë kundërshtim në lidhje me këto kërkesë, por si Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit

Kalciumi do të perdoren për trajtimin e ujit të pijshëm dhe të dy këto produkte kanë të njëjtin qëllim. Madje sasia e Hipoklorit Kalciumi është dyfishi me e lartë se ajo e Hipoklorit Natriumi dhe kjo kërkesë për paraqitjen e Lejes së importit duhet të ishte si për Hipokloritin Natriumit edhe për Hipokloritin e Kalciumit. Nderkohe që prej shumë vitesh, 2017-2023, AK ka kërkuar Lejen e Importit të Hipoklorit Kalciumi vit pas viti dhe i ka refuzuar ankesat të tilla për ta hequr këtë kriter, madje jemi skualifikuar edhe një vit për mosparaqitjen e Lejes së importit të Hipoklorit Kalciumit. Kjo bëhet për faktin se ky AK me këto kriter dhe kriterin tjetër që do citojmë më poshtë favorizon të njëjtin Operatori Ekonomik, me arsyen se ky Operatori i ka shpërndarë Leja e Importit të Hipoklorit Kalciumit.

Kërkojmë që ky kriter të modifikohet, ose të vendoset Leja e importit për të dyja mallrat objekt për shprehje ose të hiqet për të dyja.

Se treti:

2.3.3 Operatori ekonomik për Hipoklorit Natriumi 12-15%”, duhet të ketë në pronësi ose me qera ose Huapërdorje 1 mjete (autobot) të autorizuar për transport kimikatesh.

Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi) për “Transport lende të rrezikshme”, lejen e qarkullimit, plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme), duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c) Për mjetet e marra me qera ose me huapërdorje të paraqitet kontrata përkatëse e qirasëose të huapërdorjes ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetet e deklaruar ku të jenë të dukshme dhe targat e mjetit.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë në sistemin elektronik se disponon mjete për të realizuar kontratën objekt prokurimi.

Shënim: Për pikat (2.3.3) më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Përsa i përket këtij kriteri KPP është shprehur disa here duke dalë me vendimin për modifikimin e këtij kriteri gjithësesi në po e argumentojmë perseri këto kriter.

Te formulari i grafikut të levrimit të mallit ju kerkoni një sasi prej 2000 litra për 2 muaj e ndare 1500 litra do të depozitohet në Njesin Dimal dhe 500 litra në Njesin Skrapar për lenden Hipoklorit Natriumi 12-15%. Operatori jone ekonomik mallin objekt prokurimi Hipoklorit Natriumi e transporton me depozita 1000 lit ( ose 1200 kg ) të vendosura në makinë transporti të pajisur me certifikatën ADR dhe nuk është detyrimisht i nevojshëm transporti i këtij malli me autobot.

Ky mall mund të transportohet si e përmendëm më sipër dhe me depozita 1000 lit ( ose 1200 kg ) sipas grafikut të levrimit. Gjenero të demonstruar me foto mallin e lartëpërmendur të transportuar në depozita 1000 lit ( ose 1200 kg). Vendosja e këtyre kriterëve çënon hapur ligjin për Prokurimin Publik përkatësisht: Neni 2 dhe Neni 3 të Ligjit të Prokurimit Publik

Kërkojmë nga ana juaj të merren masa duke hequr ose modifikuar këto kriter pasi çënojnë parimet bazë të LPP duke përjashtuar operatorët e tjerë ekonomik, duke i shërbyer kështu eliminimit të pengesave të pajustificuara, hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës si dhe për



stimulimin e Operatoreve Ekonomik.

Kerkojme modifikimin e ketij kriteri, gjithashtu KPP ka dhene disa vendime po per te njejtin objekt prokurimi ne lidhje me kete kriter:

Vendim Nr 136/2021, Date 26.03.2021

Vendim Nr 1192/2022, Date 01.12.2022

Vendim Nr 1194/2022, Date 01.12.2022

Vendim Nr 1196/2022, Date 01.12.2022

Per sa me siper kerkojme nga ana juaj heqjen ose modifikimin e kritereve sipercituar pasi shkelin hapur parimet baze te Ligjit te Prokurimit Publik 160/2020, Neni 2, a) te rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Neni 3, 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronjë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

#### 5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)*

---

#### 6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Nuk kemi

---

#### 7. Lista e informacionit konfidencial:

Nuk kemi

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

info@adchem.al

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar**

Mamica Jançe